



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 nr.11-115
14.03.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe neni 23 paragrafi (1) alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-1091/1 datë 10.3.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1099/4 datë 13.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 10-të, mbajtur më 13.3.2023 miratoi:

Aktvendim

për vërejtje publike dhe për përjashtim të ritransmetimit të shërbimit programor

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të kominukimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë, për shkak se ka ritransmetuar shërbim programor që nuk është i regjistruar në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV). Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-1091/1 datë 10.3.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.
- OBLIGOHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë, menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë me ritransmetimin e shërbimeve programore.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe për ndalimin e ritransmetimit të shërbimit programor.
- Nëse subjekti i mbikëqyrjes përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk ka vepruar sipas aktvendimit gjegjësisht ka vazhduar të kryej shkelje për të cilën është shqiptuar masë vërejtje publike, Agjencia, në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) alinea 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.
- Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim e tij konsiderohet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) alinea 4 të LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave nga LSHMAAV ose i rregulloreve miratuar në bazë të Ligjit dhe kushtet dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike sipas kërkesës, si dhe të paketa programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të konukimit elektronik në aspekt të respektimit

të dispozitave nga ky Ligj, lejeve, vërtetimet (çertifikatat) e dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 10.3.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt kontrolli të paketës programore ritransmetua nga operatori Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë, nga ku u konstatua se operatori në fjalë i cili sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtarin në teritorrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor që nuk mbulohet me vërtetim (çertifikatë) për regjistrim të shërbimit programor e dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-1091/1 datë 10.3.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe neni 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-1091/1 datë 10.3.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1099/4 datë 13.3.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV përcaktuar në pikën 1. Të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim ku ndaj subjektit të lartpërmendur u ndërmor masë vërejtje publike dhe detyrohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që do të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhëresës, respektivisht pas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë ritransmetimin e shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, është marrë vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.11-1091/1 datë 10.3.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.